



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 180

Tiranë – E enjte, 20 dhjetor 2018

PËRMBAJTJA

Faqe

Vendim i Këshillit të Ministrave
nr. 609, datë 17.10.2018

Për miratimin e marrëveshjes së ndërmarrjes së përbashkët nga dhe
ndërmjet “Snam” S.p.a. dhe “Albgaz” sh.a., lidhur më 11 qershor 2018... 12273

**VENDIM****Nr. 609, datë 17.10.2018****PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
NDËRMARRJES SË PËRBASHKËT, NGA
DHE NDËRMJET SNAM S.P.A. DHE
ALBGAS SHA, LIDHUR
MË 11 QERSHOR 2018**

Në mbështetje të neneve 95 e 100, të Kushtetutës, dhe në vijim të vendimeve të Këshillit të Ministrave, nr. 233, datë 21.3.2017, “Për miratimin e marrëveshjes së angazhimit për zhvillimin e tregut të gazit të marrëveshjes për përfitimet vendase, të lidhura ndërmjet Republikës së Shqipërisë, e cila vepron nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe *Trans Adriatic Pipeline AG*, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik”, dhe nr. 164, datë 21.3.2018, “Për negociimin me partnerin privat të përzgjedhur nga shoqëria “Albgaz” sh.a. për krijimin e një shoqërie të përbashkët për mirëmbajtjen e rrjetit të transmetimit, të ndërtuar nga *Trans Adriatic Pipeline AG* në territorin e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes së ndërmarrjes së përbashkët, nga dhe ndërmjet “Snam” S.p.a. dhe “Albgaz” sh.a., lidhur më 11 qershor 2018.

2. Trajnimi i stafit të shoqërisë së përbashkët për realizimin e mirëmbajtjes së rrjetit të transmetimit sipas standardeve të shoqërisë TAP AG kryhet nga shoqëria “Snam” S.p.a., në përputhje me ofertën dhe marrëveshjen e lidhur me shoqërinë “Albgaz” sh.a.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe “Albgaz” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

MARRËVESHJE

**E NDËRMARRJES SË PËRBASHKËT NGA
DHE NDËRMJET SNAM S.P.A.
DHE ALBGAS SHA**

**MARRËVESHJE E NDËRMARRJES SË
PËRBASHKËT**

e lidhur në datën 11 qershor 2018
nga dhe ndërmjet

Snam S.p.A., një shoqëri aksionere (*società per azioni*) e themeluar sipas rregullave dhe që funksionon sipas ligjeve të Italisë, me zyrë të regjistruar në adresën: “Piazza Santa Barbara”, no. 7, 20097, San Donato Milanese, Italy, kod fiskal dhe TVSH numër 13271390158, regjistruar pranë Regjistrat të Shoqërive të Milanos sipas Indeksit Ekonomik-Administrativ nr. MI-1633443, e përfaqësuar nga z. Sergio Busato, si përfaqësues ligjor në bazë të një prokure të posaçme (“Snam”); nga njëra anë; dhe

Albgaz sh.a., një shoqëri aksionere, e themeluar sipas rregullave dhe që funksionon sipas ligjeve të Shqipërisë, me zyrë të regjistruar në adresën: bulevardi “Zhanë d’Ark”, 3, Tiranë, Shqipëri, kod fiskal L71306034U, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me numrin L71306034U, e përfaqësuar nga z. Arbër Avrami, në cilësinë e tij si Administrator (“Albgaz”);

nga ana tjetër,

“Snam” dhe “Albgaz”, bashkërisht të referuar si “Palët” dhe individualisht si “Palë”,

duke pasur parasysh se

A. “Snam” është një lider në Evropë në ndërtimin dhe menaxhimin e integruar të infrastrukturës së gazit natyror dhe është aktiv, nëpërmjet filialeve dhe bashkëpunëtorëve të tij, në transmetimin, rigazifikimin dhe ruajtjen e gazit natyror si në Itali ashtu edhe në vende të tjera të Bashkimit Evropian; gjithashtu, “Snam” ofron shërbime të integruara për tregun dhe nxit integrimin e rrjeteve evropiane përgjatë korridoreve kryesore kontinentale të energjisë;

B. “Snam” është një nga aksionerët e Trans Adriatic Pipeline AG (“TAP”), shoqëri e angazhuar në ndërtimin e infrastrukturës së tubacionit të gazit, e cila lidh tubacionin e gazit natyror Trans Anatolian (TANAP) në kufirin turko-grek dhe Itali, duke kaluar përmes Greqisë, Shqipërisë dhe detit Adriatik (“Gazsjellësi TAP”).



C. “Albgaz” është Operatori i Sistemit të Transmisionit (“OST”) i ngarkuar nga Qeveria shqiptare për të kryer të gjitha aktivitetet e funksionimit dhe mirëmbajtjes në lidhje me Gazsjellësin TAP, në bashkëpunim me një partner ndërkombëtar me përvojë;

D. a) Kjo Marrëveshje e Ndërmarrjes së Përbashkët (kjo “Marrëveshje”); dhe b) Marrëveshja e Aksionerëve (siç përcaktohet më poshtë), në çdo rast, do të jetë në çdo kohë objekt i kushteve të përcaktuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 164, të datës 21.3.2018, “Për bisedimet me partnerin privat të përzgjedhur nga “Albgaz” sh.a., për krijimin e një ndërmarrjeje të përbashkët për mirëmbajtjen e rrjetit të transmetimit të ndërtuar nga TAP në territorin e Republikës së Shqipërisë” (“VKM 164”);

E. “Albgaz” ka përzgjedhur “Snam”-in pas një procedure përzgjedhëse konkurruese, si një partner me përvojë dhe kompetent për performancën e “Snam”-it për disa shërbime të lidhura me Objektin/Fushën e Veprimit (të përcaktuar më poshtë);

F. Përvojat dhe njohuritë që “Snam”, fituesi i tenderit, do të fitonte nëpërmjet ofrimeve të shërbimeve të sipërpërmendura, do ta poziciononin fituesin si një partner potencial për pjesëmarrje në projektet e ardhshme “Albgaz” në Shqipëri, në çdo rast, në masën e lejuar nga ligjet në fuqi/ të zbatueshme;

G. Palët kanë vendosur të krijojnë një shoqëri të shërbimeve plotësisht funksionale të shërbimeve që do të themelohet sipas ligjeve shqiptare (“NewCo”), e cila do të caktohet drejtpërdrejt nga TAP për të siguruar operimin, mirëmbajtjen dhe shërbimet teknike për TAP-in nëpërmjet një marrëveshjeje shërbimesh që do të lidhet (“Marrëveshja e Shërbimeve TAP”) dhe janë të gatshëm që “Snam” të kontribuojë si ofrues shërbimesh në përmbushjen e Marrëveshjes së Shërbimit TAP (“Objekti Ndihmës”).

H. Kjo Marrëveshje përcakton termat dhe kushtet mbi të cilat Palët bien dakord të bashkëpunojnë dhe marrin përsipër ndërmarrjen e përbashkët të lartpërmendur.

Tashmë, si rrjedhojë, duke marrë në konsideratë pikat e mëparshme, të cilat përbëjnë kushtet paraprake faktike dhe pjesë integrale dhe thelbësore të kësaj marrëveshjeje, Palët bien dakord si më poshtë:

1. DISA PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

1.1 Specifikimet dhe shtojcat

Specifikimet e mësipërme dhe shtojcat e bashkëlidhura këtij dokumenti përbëjnë pjesë integrale dhe thelbësore të kësaj Marrëveshjeje.

1.2 Përkufizimi

Përveç kushteve të përcaktuara në klauzolat e tjera të kësaj marrëveshjeje ose në shtojcat e saj, për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet e përcaktuara më poshtë.

1.2.1 “Administrator” nënkupton secilin prej Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv (CEO) dhe Drejtorit të Përgjithshëm Operacional (COO), ku secili i jepen kompetenca individuale dhe të përbashkëta, sipas rastit, për menaxhimin e duhur të veprimtarive strategjike, industriale, tregtare dhe operacionale të “NewCo”, në përputhje me dispozitat përkatëse të Marrëveshjes së Aksionerëve;

1.2.2 “Autorizime”, në lidhje me secilën Palë, nënkupton çdo autorizim, leje ose miratim që duhet të merret nga kjo Palë në lidhje me pjesëmarrjen e saj në “NewCo” dhe përmbushjen e Objektit;

1.2.3 “Ditë Pune” nënkupton çdo ditë kalendarike përveç të shtunave, të dielave dhe çdo ditë tjetër në të cilën institucionet e kredisë lejohen të mbyllen në qytetin e Tiranës;

1.2.4 “Plan Biznesi” nënkupton planin e biznesit të “NewCo” për periudhën 2018–2024 bashkëlidhur si shtojca A, të ndryshuar më pas në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Aksionerëve;

1.2.5 “Akte nënligjore” nënkupton aktet nënligjore që do të miratohen nga “NewCo” pas përfshirjes së saj, duke përcaktuar, në masën maksimale të lejuar sipas ligjeve në fuqi, ndër të tjera, parimet e përfshira në Marrëveshjen e Aksionerëve;

1.2.6 “Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv” do të thotë drejtori i përgjithshëm ekzekutiv i “NewCo”, i caktuar nga “Albgaz”, i cili do të jetë Administrator;

1.2.7 “Drejtor i Përgjithshëm Financiar” do të thotë drejtori i përgjithshëm financiar i “NewCo”, i caktuar nga “Albgaz”, i cili nuk do të jetë Administrator;

1.2.8 “Drejtor i Përgjithshëm Operacional” do të thotë drejtori i përgjithshëm operacional i



“NewCo”, i caktuar nga “Snam”, i cili do të jetë Administrator;

1.2.9 “Përfundim” nënkupton kryerjen e secilit dhe të gjitha aktiviteteteve të parashikuara në Klauzolën 4 për të përfshirë “NewCo”;

1.2.10 “Data e përfundimit” do të thotë data që bie në Ditët e 15 (pesëmbëdhjetë) të Punës pas përmbyshjes (ose heqjes dorë nga) të gjitha Kushtet Paraprake, me të cilat Palët do të kryejnë dhe/ose do të marrin masa për kryerjen e të gjitha aktiviteteteve të parashikuara sipas Klauzolës 4 më poshtë që përbëjnë Përfundimin;

1.2.11 “Kushtet Paraprake” ka kuptimin e caktuar në klauzolën 3;

1.2.12 “Datë e Kushteve paraprake” nënkupton datën 27 qershor 2018;

1.2.13 “Datë e hyrjes në fuqi” nënkupton datën në të cilën kjo Marrëveshje është zbatuar nga të dyja Palët.

1.2.14 “Forcë Madhore” nënkupton akte të mbinatyrshme; grevat, mbylljet e ndërmarrjeve ose mosmarrëveshjet apo problemet industriale; trazirat civile; arrestimet dhe kufizimet nga sunduesit /udhëheqësit e popujve; ndërprerjet me urdhër të qeverisë, agjencisë administrative ose gjykatës, përveçse rasteve që shkaktohen si rezultat i mosrespektimit të ligjeve; urdhrave të vlefshëm aktualë dhe të ardhshëm, vendimet ose urdhrat e çdo organi qeveritar ose administrativ që ka juridiksionin e duhur; veprimet e një armiku publik; luftërat; trazirat; bllokadat; kryengritjet; epidemitë; rrëshqitjet e tokës; rrufetë; tërmetet; zjarret; shtrëngatat; përmblytjet; erozionet, qoftë të llojit të përmendur këtu ose ndryshe, të cilat nuk janë në mënyrë të arsyeshme nën kontrollin e Palëve dhe që nuk shkaktohen, tërësisht ose pjesërisht, nga veprimet ose mosveprimet e Palëve.

1.2.15 “Ligjet” ose “Ligjet në fuqi” nënkupton të gjitha ligjet shqiptare, statutet, rregullat, rregulloret, dekretet dhe deklaratimet e tjera shqiptare që kanë fuqi detyruese të ligjit të çdo autoriteti qeveritar në fuqi, gjykatë, tribunali, agjencie, organi legjislativ, komisioni ose instrumenti të Republikës së Shqipërisë, të cilat janë drejtpërdrejt detyruese për personin e përmendur në kontekstin në të cilin përdoret një fjalë e tillë dhe “Ligj” ose “Ligj në fuqi” nënkupton secilin prej tyre;

1.2.16 “Zyrtar për Operimin dhe Mirëmbajtjen” nënkupton zyrtarin për operacionet dhe mirëmbajtjen që caktohet nga “Snam” dhe që nuk do të jetë Administrator.

1.2.17 “Zyrtar për prokurimet” nënkupton zyrtarin e emëruar nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, nëpërmjet emërimit të “Snam”-it, i cili nuk do të jetë Administrator dhe do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Rregullores së Prokurimit dhe Procedurës së Prokurimit në çdo proces tenderimi në lidhje me marrëveshjet e shërbimeve të ndryshme me palët e treta, nëse ka, për kryerjen e të gjithë ose një pjesë të fushës së veprimit/objektit.

1.2.18 “Procedurë Prokurimi” nënkupton procedurën e prokurimit të përcaktuar në shtojcën B të kësaj Marrëveshjeje që bazohet në rregullat dhe procedurat e prokurimit të “Snam”-it, të cilat janë të zbatueshme vetëm në masën që janë në përputhje me ligjet në fuqi dhe që shfrytëzon parimet e preferencave të kontraktuesit vendor të përcaktuara në të, të cilat detajohen më tej nga “NewCo” bazuar në shtojcën B, rregullat dhe procedurat e prokurimit të “Snam”-it dhe në përputhje me ligjet në fuqi;

1.2.19 “Rregullat e Prokurimit” nënkupton rregullat dhe procedurat e prokurimit të parashikuara nga ligji shqiptar nr. 9643, i datës 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

1.2.20 “Objekt/Fushë veprimi” nënkupton objektin e punës që kryhet nga “NewCo” në lidhje me Marrëveshjen e Shërbimeve të TAP-it, siç përcaktohet më specifikisht në VKM 164;

1.2.21 “Marrëveshje e Aksionerëve” nënkupton marrëveshjen e aksionerëve ndërmjet “Snam” dhe “Albgaz”, për të cilën është rënë dakord midis Palëve për t’u negociuar në mirëbesim bazuar në termat dhe kushtet e përcaktuara në shtojcën A “Pasqyra e termave dhe kushteve materiale të Marrëveshjes së Aksionerëve” bashkëlidhur këtu që do të lidhet ndërmjet “Snam” dhe “Albgaz”, e cila përfshin, ndër të tjera: i) rregullat e qeverisjes/drejtimit të “NewCo”; ii) rregullat që zbatohen për disa raste të veçanta që mund të çojnë në daljen e “Snam”-it nga kapitali aksioner i “NewCo” dhe si pasojë i dhënies fund të ndërmarrjes së përbashkët; dhe iii) disa detyrime të mëtejshme të Palëve në lidhje me sjelljen e tyre në zbatimin e Ndërmarrjes së Përbashkët



1.2.22 “Standarde teknike” nënkupton specifikimet teknike të përcaktuara nga “Snam” në lidhje me përmbushjen e fushës së veprimit/objektit. Për shmangien e dyshimit, standardet teknike, duke përfshirë ato të parashtruara si pjesë e Rregullores së Prokurimit, në asnjë rast nuk i tejkalojnë specifikimet teknike të caktuara ose të kërkuara nga TAP.

1.3 Interpretimi

1.3.1 Titujt dhe nëntitujt e klauzolave jepen vetëm për lehtësi referimi dhe nuk ndikojnë në interpretimin dhe strukturën e kësaj Marrëveshjeje. Përveç rasteve kur shprehimisht kërkohet ndryshe nga konteksti, të gjitha referencat në këtë Marrëveshje për çdo Klauzolë dhe/ose çdo germë janë në klauzolën përkatëse dhe/ose në germën përkatëse të Marrëveshjes, përveç nëse specifikohet ndryshe.

1.3.2 Çdo referim i një dispozite të ndonjë ligji që është aktualisht në fuqi konsiderohet njëloj i zbatuar për dispozitat e çdo ligji që mund të modifikojë ose plotësojë përmbajtjen e tyre.

1.3.3 Përveç rasteve kur kërkohet ndryshe nga konteksti, fjala që tregon numrin njëjës përfshin edhe shumësin dhe anasjelltas; fjalët që tregojnë ndonjë gjini përfshijnë të gjitha gjinitë. Fjalët “e së cilës”, “në të cilën” dhe “në vijim” dhe fjalët me kuptim të ngjashëm me to, kur përdoren në Marrëveshje, i referohen kësaj Marrëveshjeje në tërësi. Fjala “që përfshin”, ose çdo ndryshim ë saj, nënkupton “që përfshin, pa kufizim” dhe nuk interpretohet për të kufizuar ndonjë deklaram të përgjithshëm për pika ose çështje specifike ose të ngjashme që vijnë menjëherë pas saj.

1.3.4 Detyrimi i një Pale për të ndërmarrë ose mundësuar ndërmarrjen e të gjitha veprimeve, si dhe për të kryer ose për të mundësuar realizimin e të gjitha pikave që janë të nevojshme në mënyrë të arsyeshme, të përshtatshme ose të këshillueshme sipas ligjeve në fuqi për të përmbushur një objektiv, do të interpretohet si një detyrim i përpjekjeve dhe jo si një detyrim i rezultatit specifik dhe kjo nuk kërkon shpenzim fondesh apo lindjen e një detyrimi nga ana e një Pale të tillë, nëse objektivi përkatës nuk arrihet për çfarëdo arsye.

2. QËLLIMI I MARRËVESHJES: THEMELIMI I “NEWCo” DHE BIZNESI

2.1 Në pajtim me Kushtet Paraprake dhe në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje, palët bien dakord të hyjnë në një

ndërmarrje të përbashkët nëpërmjet themelimit të “NewCo”, siç përshkruhet më mirë në klauzolën 4 më poshtë. Palët bien dakord që “NewCo” do të ngrihet si një shoqëri me shërbime tërësisht operacionale, e cila do të jetë përgjegjëse për kryerjen e funksionimit, mirëmbajtjes dhe shërbimeve teknike për TAP sipas Marrëveshjes së Shërbimeve TAP.

2.2 Secila Palë do të përmbushë detyrimet e saj në lidhje me Objektin/Fushën e Veprimit dhe të gjitha detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje dhe sipas marrëveshjeve të tjera, nëse ka, në të cilat ajo hyn në marrëveshje me “NewCo” ose në emër të “NewCo”, në përputhje të plotë me kushtet e saj, në mënyrë profesionale dhe të matur, si dhe në përputhje me standardet, procedurat dhe praktikën e përgjithshme të pranuar të industrisë dhe standardeve profesionale që plotësojnë pritshmëritë e arsyeshme të “NewCo”.

Secila Palë bie dakord që të gjitha punimet e kryera dhe shërbimet e ofruara për “NewCo” ose në emër të “NewCo”, të jenë në pajtim me të gjitha ligjet në fuqi dhe dispozitat përkatëse kontraktuale të miratuara për këto shërbime, duke përfshirë, sipas rastit, pa kufizim, të gjitha kërkesat në fuqi sipas Marrëveshjes për Ndërtimin e Kapaciteteve, Marrëveshjes së Shërbimeve TAP dhe çdo marrëveshje tjetër në fuqi. “Albgaz” pranon se “Snam” mund të përdorë cilindo nga degët në pronësi të plotë të saj për të kryer në tërësi dhe/ose pjesërisht çdo detyrim të saj sipas kësaj Marrëveshjeje.

2.3 Secila palë duhet të respektojë dhe të mundësojë që nënkontraktuesit dhe bashkëpunëtorët e tyre, nëse ka, të respektojnë të gjitha ligjet në fuqi dhe të kenë të gjitha licencat, lejet, certifikatat dhe regjistrimet profesionale që kërkohen për përmbushjen e Objektit/Fushës së Veprimit dhe detyrimet e tjera në vijim.

2.4 Me qëllim të realizimit të Objektit/Fushës së veprimit, “NewCo” ka të drejtë të sigurojë prokurimin e shërbimeve të caktuara nga Palët dhe nga palët e treta. Për sa i përket pjesës së ndërtimit të kapaciteteve të Objektit/Fushës së veprimit, Palët pranojnë që aktivitete të tilla janë ofruar për t’u kryer nga “Snam” si pjesë e fazës së tenderimit. Aktivitete të tilla mund të kryhen në bazë të një skeme kontraktuale për t’u rënë dakord (“Marrëveshja për Ndërtimin e Kapaciteteve”), me kusht që nëse Palët bien dakord për arritjen e një



marrëveshje ndërmjet “Snam” dhe “NewCo”, atëherë “Snam” dhe “Albgaz” do të pranojnë dhe bien dakord se nuk do të lindin detyrime ose përgjegjësi financime në llogari të “NewCo” për shkak të performancës së “Snam”-it sipas Marrëveshjes për Ndërtimin e Kapaciteteve para pagesës nga TAP të tarifave përkatëse për “NewCo”. Megjithatë, “Snam” nuk ka detyrim për përmbushje në bazë të Marrëveshjes për Ndërtimin e Kapaciteteve në masën që nuk ekziston një marrëveshje midis TAP, “NewCo” dhe /ose “Snam” për kompensimin e “Snam”-it në lidhje me një përmbushje të tillë.

2.5 Në masën që “NewCo” synon të sigurojë shërbimet e palëve të treta për të përmbushur të gjithë ose një pjesë të Objektit/Fushës së Veprimit, prokurimi i këtyre shërbimeve kryhet në përputhje me ligjet në fuqi. Një prokurim i tillë kryhet në pajtim me Rregulloren në fuqi të Prokurimit dhe Procedurën e Prokurimit.

2.6 Palët bien dakord që “NewCo” të ketë përgjegjësinë e përgjithshme të ofrimit të objektit/fushës së veprimit dhe që, në përputhje me termat dhe kushtet e Planit të Biznesit, të vendosë nëse: a) të punësojë personelin e kërkuar për të kryer të gjithë ose një pjesë të objektit/fushës së veprimit; dhe/ ose b) të mbështesë me burime të jashtme aktivitetet nëpërmjet marrëveshjeve të shërbimeve.

3. KUSHTET PARAPRAKE

3.1 Hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje (me përjashtim të këtij neni 3.1 dhe nenit 9 (mbi konfidencialitetin), nenit 12 (mbi etikën e biznesit dhe antimitmarjen), nenit 13 (të ndryshme) dhe nenit 14 (mbi ligjin dhe juridiksionin rregullues), të cilat janë detyruese duke filluar nga data e kësaj Marrëveshjeje), është objekt dhe kushtëzohet nga përmbushja e kushteve të mëposhtme paraprake (që duhet të plotësohen siç duhet dhe në kohë maksimumi deri në Datën e Kushteve Paraprake):

i. Marrëveshja e ndërsjellë e Palëve mbi kushtet dhe përmbajtjen e Planit të Biznesit, aktet nënligjore të reja të “NewCo” dhe të Marrëveshjes së Aksionerëve, të cilat do të hartohen në bazë të pasqyrës së termave dhe kushteve materiale të marrëveshjes së aksionerëve të bashkëlidhur në shtojcën A;

ii. Përfundimi i negocimit të Marrëveshjes së Shërbimeve TAP dhe dhënia përfundimtare e kësaj marrëveshjeje nga TAP së bashku për “Snam” dhe “Albgaz” në emër dhe për llogari të “NewCo”;

iii. Dërgimi nga secila Palë për Palën tjetër të të gjitha autorizimeve, licencave dhe lejeve në fuqi të kërkuara nga ndonjë autoritet antitrust, ministri ose autoritet tjetër qeveritar, me qëllim të: a) themelimit të “NewCo”, dhe b) kryerjes nga “NewCo” të Objektit/Fushës së Veprimit dhe kryerjes së çdo aktiviteti tjetër të “NewCo”, duke përfshirë ato në kuadër të Marrëveshjes së Shërbimeve të TAP-it.

3.2 Kjo Marrëveshje, me përjashtimet e përcaktuara në nenin 3.1, konsiderohet automatikisht e ndërprerë dhe nuk ka më fuqi dhe efekt të mëtejshëm dhe pa përgjegjësi të asnjë prej Palëve nëse, në ose para Datës së Kushteve Paraprake, një ose më shumë nga kushtet paraprake të parashtruara sipas nenit 3.1 më sipër nuk është plotësuar ose nuk është hequr dorë nga të dyja Palët, me kusht që nëse një Kusht Paraprak sipas nenit 3.1, paragrafi (iii) më sipër nuk është plotësuar nga një Palë dhe është hequr nga Pala tjetër, kjo Marrëveshje mbetet në fuqi dhe një Kusht Paraprak i tillë i paplotësuar kthehet në një detyrim të detyrueshëm të Palës që i ishte kërkuar fillimisht për të përmbushur këtë Kusht Paraprak para Datës së Kushteve Paraprake.

3.3 Përmbushja e çdo Kushti Paraprak të mësipërm provohet, duke i treguar Palës tjetër dokumentacionin e nevojshëm që dëshmon në mënyrë të arsyeshme një përmbushje të tillë.

4. PËRFUNDIMI

4.1 Pas plotësimit të Kushteve Paraprake, në ose para Datës së Përfundimit:

a) “Snam” dhe “Albgaz” kryejnë të gjitha aktivitetet e kërkuara sipas ligjeve në fuqi për të përfshirë “NewCo” në mënyrë të rregullt dhe të vlefshme në formën e një shoqërie aksionere sipas ligjeve në fuqi, të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dhe duke pasur strukturën drejtuese/qeverisëse të përcaktuar në Pasqyrën e Termave dhe Kushteve Materiale të Marrëveshjes së Aksionerëve, dhe kapitali aksioner i “NewCo” nënshkruhet dhe paguhet si më poshtë:

i. “Albgaz” nënshkruan një aksion që përfaqëson 75% të kapitalit aksioner të “NewCo” dhe paguan 2.625.000 lekë (dy milionë e gjashtëqind e njëzetepesë mijë) si kapital nominal. Çdo prim, nëse ka, parashikohet në Marrëveshjen e Aksionerëve.

ii. Snam nënshkruan një aksion që përfaqëson 25% të kapitalit aksioner të “NewCo” (“Aksionet e Pakicës”) dhe paguan 875,000 lekë (tetëqind e



shtatëdhjetë e pesë mijë) si kapital nominal. Çdo prim, nëse ka, parashikohet në Marrëveshjen e Aksionerëve.

b) Palët zbatojnë Marrëveshjen e Aksionerëve;

c) Palët do të mundësojnë që:

i. Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës, të cilët mbeten në detyrë për një afat jo më të gjatë se tre (3) vite financiare, ndërsa një afat i tillë ndërpritet ose rinovohet në përputhje me Marrëveshjen e Aksionerëve, emërohen në përputhje me Marrëveshjen e Aksionerëve, si më poshtë:

- dy (2) anëtarë të caktuar nga “Snam”;
- tre (3) anëtarë të caktuar nga “Albgaz”;

ii. Bordi Mbikëqyrës emëron Kryetarin e tij (të caktuar nga “Snam”), Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv (të caktuar nga “Albgaz”), Drejtorin e Përgjithshëm të Operacioneve (të caktuar nga “Snam”), Drejtorin e Përgjithshëm të Financës (të caktuar nga “Albgaz”) dhe Përgjegjësin për Operacionet dhe Mirëmbajtjen (të caktuar nga “Snam”);

iii. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Drejtori i Përgjithshëm i Operacioneve kanë autoritetet dhe kompetencat e përcaktuara në Marrëveshjen e Aksionerëve;

iv. Plani i Biznesit miratohet për t’u bërë i vlefshëm;

v. NewCo lidh (x) Marrëveshjen e Shërbimeve TAP dhe (y), në rast se skema kontraktuale e rënë dakord sipas Klauzolës 2.4 është një marrëveshje ndërmjet Snam dhe NewCo, në Marrëveshjen për Ndërtimin e Kapaciteteve, në secilin rast, në përputhje me Ligjet në Fuqi;

vi. Zyrtari për Prokurimet emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv sipas caktimit nga ana e “Snam”-it.

d) Palët kryejnë dhe zbatojnë dhe/ose mundësojnë gjithashtu përmbushjen dhe zbatimin - duke u dhënë Këshillit Mbikëqyrës ose Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Operacioneve, sipas rastit, kompetencat përkatëse të çdo aktiviteti dhe instrumenti tjetër të nevojshëm dhe/ose të përshtatshëm për të themeluar “NewCo”, për të përmbushur dhe zbatuar veprimet e përshkruara në këtë Klauzolë 4.1 dhe në përgjithësi për zbatimin siç duhet të qëllimeve të kësaj Marrëveshjeje.

4.2 Është rënë dakord që të gjitha veprimet dhe transaksionet që përbëjnë Përfundimin sipas kësaj Klauzole 4 konsiderohen si një transaksion i vetëm,

në mënyrë që sipas opsionit të Palës që ka interes për kryerjen e veprimit dhe transaksionit të veçantë, asnjë veprim ose transaksion nuk konsiderohet se ka ndodhur nëse dhe derisa të gjitha veprimet ose transaksionet e tjera që përbëjnë Përfundimin të kenë ndodhur siç parashikohet në këtë Marrëveshje.

4.3 Është rënë dakord që në rast se ndonjë Palë shkel materialisht detyrimet e saj të parashikuara në këtë klauzolë 4, dhe nëse një shkelje e tillë materiale nuk ka ndodhur për shkak të Forcës Madhore ose të ketë lidhje me veprimet apo mosveprimet nga TAP ose nga Pala tjetër, duke përfshirë mospërmbushjen e Kushteve Paraprake nga një Palë tjetër e tillë, dhe nëse si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e një shkelje të tillë materiale, Përfundimi nuk është kryer në mënyrë të duhur në Datën e Përfundimit, atëherë Pala që kryen shkeljen është përgjegjëse ndaj Palës që nuk ka kryer ndonjë shkelje për çdo apo të gjitha dëmet e drejtpërdrejta të pësuar për shkak të një shkeljeje të tillë materiale.

5. PËRFAQËSIMET, GARANCITË DHE ZHDËMTIMET/DËMSPËRBLIMET

5.1 Snam kryen përfaqësimet dhe garancitë e mëposhtme për “Albgaz”-in dhe vërteton se çdo përfaqësim dhe garanci e tillë është e vërtetë dhe e plotë nga data e kësaj Marrëveshjeje dhe që do të jetë e vërtetë dhe e plotë nga Data e Përfundimit, dhe gjithashtu pranon që “Albgaz” bazohet në të në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje:

5.1.1 Të përgjithshme. Nuk ka marrëveshje, mundësi, detyrime, të drejta ose sipërmarrje të tjera që mund të pengojnë zbatimin e transaksioneve të parashikuara në këtë Marrëveshjeje.

5.1.2 Autoriteti. “Snam” është një korporatë e organizuar siç duhet, me fuqi të ligjshme dhe në gjendje të favorshme nën ligjet e juridiksionit të saj të themelimit. “Snam” ka fuqinë dhe autoritetin e plotë për të përmbushur Marrëveshjen, si dhe të gjithë fuqinë dhe autoritetin e nevojshëm për të zbatuar dhe realizuar Marrëveshjen dhe për të përmbushur detyrimet në vijim të “Snam”-it.

5.1.3 Kompetenca. “Snam” ka: a) aftësitë teknike, burimet dhe mjetet për të garantuar cilësinë e kërkuar të shërbimeve që do të kryhen sipas kësaj Marrëveshjeje; b) kapacitetin financiar dhe burimet njerëzore për të përmbushur këtë Marrëveshjeje në përputhje me termat e saj; dhe c) të gjitha licencat, akreditimet, të drejtat dhe miratimet



e nevojshme, kur është e mundur, për përmbushjen e Objektivit, Fushës së Veprimit.

5.1.4 Pajtueshmëria me ligjet. “Snam” duhet të jetë në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi në lidhje me projektimin, origjinën, modifikimin dhe ofrimin e të gjitha shërbimeve dhe produktit të punës që nevojiten ose përdoren për përmbushjen e objektivit/ fushës së veprimit dhe detyrimeve të tjera sipas kësaj Marrëveshjeje.

5.2 “Albgaz” kryen përfaqësimet dhe garancitë e mëposhtme tek Snam-i dhe vërteton se çdo përfaqësim dhe garanci e tillë është e vërtetë dhe e plotë nga data e kësaj Marrëveshjeje, dhe që do të jetë e vërtetë dhe e plotë nga Data e Përfundimit, dhe gjithashtu pranon që Snam-i mbështet zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

5.2.1 Të përgjithshme. Nuk ka marrëveshje, mundësi, detyrime, të drejta ose sipërmarrje të tjera të cilat mund të pengojnë zbatimin e transaksionit të parashikuar në këtë Marrëveshjeje.

5.2.2 Autoriteti. “Albgaz” është një korporatë e organizuar siç duhet, me fuqi të ligjshme dhe në gjendje të favorshme sipas ligjeve të juridiksionit të saj të themelimit. “Albgaz” ka fuqinë dhe autoritetin e plotë për të kryer Marrëveshjen, si dhe të gjithë fuqinë dhe autoritetin e duhur për të zbatuar dhe zbatuar Marrëveshjen dhe për të kryer detyrimet në vijim të “Albgaz”.

5.2.3 Pajtueshmëria me ligjet. “Albgaz” duhet të veprojë në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje.

5.2.4 Tenderi. Sipas njohurive më të mira të “Albgaz”-it, përgatitja dhe zbatimi i procedurës së tenderit është kryer në përputhje me ligjet në fuqi dhe “Albgaz” përfaqëson dhe garanton që në dijeninë më të mirë të të saj, nuk ka pretendime, akuza, padi apo ndonjë çështje të ngjashme të tillë, të depozituar ose kërcënim/rrezik nga ndonjë palë e tretë që kundërshton tenderin ose rezultatin e tij.

5.3 Sigurimi/siguracioni. Secila palë, në masën që ofron shërbime për “NewCo”, duhet të ruajë në fuqi dhe t’i ofrojë “NewCo” dëshmi arsyeshmërisht të kënaqshme për mbulimin e sigurimeve nga një shoqëri e njohur sigurimesh, duke siguruar ndaj të gjitha rreziqeve që mund të lindin gjatë përmbushjes dhe kohëzgjatjes së shërbimeve përkatëse. Një sigurim i tillë heq dorë nga e drejta e subrogimit/zëvendësimit ndaj “NewCo”. Sipas kërkesës së “NewCo”, Pala përkatëse do t’i ofrojë

“NewCo” dëshminë e mbulimit të pagesës së saj të sigurimit. Pala përkatëse është përgjegjëse për çdo pagesë në bazë të zbritjes/eve së saj ose të mbajtjeve të vetësiguruara. Pala përkatëse siguron dëshmi me shkrim se “NewCo” caktohet si përfitues i sigurimit sipas policës së sigurimit të lartpërmendur.

5.4 Secila Palë dëmshpërblen, mbron dhe mban të padëmtuar, në masën maksimale të lejuar nga ligjet në fuqi, “NewCo”-në, Palën tjetër dhe secilën nga degët e saj ndaj të gjitha pretendimeve, fakteve për paraqitjen e padive, padive dhe detyrimeve, duke përfshirë dëmet, gjokat, penalitetet, tarifat ligjore dhe tarifat dhe shpenzimet e tjera profesionale, të dhëna ndaj ose shkaktuar apo paguar nga secila palë e dëmtuar si rezultat i ose në lidhje me ndonjë veprim, mosveprim, papërshtatshmëri, neglizhencë, mospërmbushje detyrimesh ose gabim që i atribuohet Palës së dëmshpërblimit, personelit të saj, nënkontraktuesit ose personelit të nënkontraktuesve të tij në përmbushjen e objektivit/fushës së veprimit dhe detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë, por pa u kufizuar në mosrespektimin e termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

6. KOSTOT DHE SHPENZIMET

6.1 Nënkuptohej që në rast se kjo Marrëveshje ndërpritet për shkak të mospërmbushjes së ndonjë Kushti Paraprak (dhe mungesës së heqjes dorë prej saj), të gjitha shpenzimet, tarifat dhe shpenzimet që paguhën nga secila Palë në lidhje me projektin e parashikuar në të, mbeten në ngarkim të Palës që i ka mbështetur këto shpenzime.

6.2 Secila Palë do të mbulojë koston, tarifat dhe shpenzimet që rrjedhin për lidhjen e kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë pa kufizim, shpenzimet e veta për udhëtim dhe kostot e brendshme, midis të cilave kostot e brendshme të lidhura me negocimin, përgatitjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe të Marrëveshjes së Aksionerëve dhe në përgjithësi, me negocimin dhe zbatimin e çdo marrëveshjeje tjetër ndërmjet Palëve. Kostoja dhe shpenzimet për themelimin e “NewCo” mbulohen nga “NewCo”.

7. KOHËZGJATJA DHE ZGJIDHJA E MARRËVESHJES

7.1 Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi dhe efekt të plotë për një afat prej 5 (pesë) vitesh nga Data e Hyrjes në Fuqi (“Afati fillestar”). Palët bien dakord që “Snam”-i do të ketë të drejtë ta ndërpresë këtë



Marrëveshje në rast se Synimi Ndhimës nuk është ndjekur apo përmbushur.

Gjatë vitit para skadimit të Afatit Fillestar, në varësi të Opsionit të Shitjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar dhe Opsionit të Blerjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar (të dyja siç përcaktohen në Klauzolën 8 më poshtë) dhe të drejtës së ndërprerjes së “Snam”-it që nuk është duke u ushtruar, Palët negociojnë në mirëbesim termat dhe kushtet (duke përfshirë, por pa u kufizuar në të drejtën e parapagimit dhe mekanizmat e transferimit të aksioneve) të një rinovimi të mundshëm të kësaj marrëveshjeje për 2 (dy) vjet (çdo afat rinovimi, një “Afat rinovimi”). Çdo Palë pranon dhe pajtohet që numri maksimal i Termave të Rinovimit të jetë 2 (dy), me një afat rinovimi përfundimtar jo më shumë se 1 (një) vit.

7.2 Nëse kjo Marrëveshje skadon ose përfundon, ndërpritet gjithashtu edhe Ndërmarrja e Përbashkët dhe të gjitha detyrimet e Palëve në vijim, me përjashtim të atyre detyrimeve të përcaktuara shprehimisht në këtë Marrëveshje ose që synojnë të vazhdojnë edhe pas skadimit ose përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, nuk kanë më fuqi ose efekt.

8. OPSIONI I SHITJES SË AKTIVËVE /ASETEVE ME ÇMIM TË CAKTUAR DHE NË KOHË TË CAKTUAR DHE OPSIONI I BLERJES SË AKTIVËVE/ASETEVE ME ÇMIM TË CAKTUAR DHE NË KOHË TË CAKTUAR

8.1 Dhënia e opsionit të blerjes së aktivëve/aseteve me çmim të caktuar dhe në kohë të caktuar.

a) “Snam” i jep “Albgaz”-it të drejtën dhe mundësinë për të blerë në përvjetorin e pestë të datës së themelimit të “NewCo”, pa pengesa, Aksionet e Pakicës (“Opsioni i Blerjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar”). Me ushtrimin nga ana e “Albgaz” të Opsionit të Blerjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar, Albas blen, në përvjetorin e pestë të themelimit të “NewCo”, ndërsa “Snam”-i shet aksionet e Pakicës. E drejta e Opsionit të Blerjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar të dhënë për “Albgaz” mund të ushtrohet sipas termave dhe modaliteteve të përcaktuara më poshtë:

i. Duke filluar nga përvjetori i katërt i datës së themelimit të “NewCo”, “Snam”-i dhe “Albgaz”-i takohen dhe vlerësojnë bashkërisht mundësinë për të zgatur kohëzgjatjen e ndërmarrjes së përbashkët, për një periudhë prej gjashtë muajsh;

ii. Nëse negociatat e mirëbesimit sipas germës (i) më sipër nuk çojnë në një vendim të përbashkët për zgjatjen e kohëzgjatjes, Opsioni i Blerjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar mund të ushtrohet nga “Albgaz” brenda pesë vjetorit të datës së kësaj Marrëveshjeje (“Afati i Opsionit të Blerjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar”), duke i dhënë njoftim me shkrim Snam-it për zgjedhjen e tij për të ushtruar Opsionin e Blerjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar (“Njoftimi për Opsionin e Blerjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar”), përveç rastit kur “Albgaz”-i i ka ofruar “Snam”-it, të paktën 6 (gjashtë) muaj para pesë vjetorit të themelimit të “NewCo”-s, një njoftim të parevokueshëm me shkrim për synimin e saj për të ushtruar Opsionin e Blerjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar;

iii. Çmimi i aksioneve të “NewCo” përfaqëson vlerën e drejtë të tregut, duke marrë parasysh që: a) “NewCo” është themeluar si një shoqëri shërbimesh përgjegjëse për kryerjen e operacioneve, mirëmbajtjes dhe shërbimeve teknike vetëm për TAP nën Marrëveshjen e Shërbimeve të TAP-it; dhe që b) “Snam” do të ketë marrë tashmë 5 (pesë) vjet tarifa nga “NewCo” për ofrimin e shërbimeve të ndërtimit të kapaciteteve, siç përcaktohet në nenin 2.2 të këtij ligji. Vlera e drejtë e tregut, e llogaritet në bazë të metodologjisë së Fluksit të Parave të Zbritura të Paeksploruara (“UDCF”) që zbatohet në Planin e fundit të Biznesit të disponueshëm, i cili do të ketë parashikime të qarta për një periudhë jo më të shkurtër se 5 vjet. Palët bien dakord në mirëbesim mbi normën e skontos/uljes (“Norma e Skontos”) që do të përdoret për qëllimet e UDCF-së; nëse një marrëveshje nuk arrihet brenda 15 ditëve të punës, palët do t’i referohen Ekspertit (siç përcaktohet më poshtë), i cili kryen një vlerësim të pavarur të Normës së Skontos që do të përdoret për qëllimin e UDCF-së. Nëse për ndonjë arsye Shoqëria nuk do të ketë një Plan Biznesi të disponueshëm në kohën e njoftimit të Opsionit të Blerjes së



Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar ose nëse Plani i Biznesit do të ketë parashikime të qarta prej më pak se 5 vjetësh dhe nuk do të jetë e mundur që ato të zhvillohen, dhe nëse nuk do të jetë e mundur të zhvillohet/ bihet dakord mbi një plan biznesi të ri me karakteristika të tilla, atëherë vlera e drejtë e aksioneve të “Snam”-it në Shoqëri do të jetë e barabartë me kontributet kapitale të “Snam”-it, secila e kapitalizuar me një Normë të Brendshme të Kthimit (“IRR”) prej 15% (“Çmimi i Caktuar”);

iv. në rast se Opsioni i Blerjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar ushtrohet në mënyrë të rregullt, “Snam” nuk do të ketë detyrime të mëtejshme (si garanci, dëmshpërblim ose ndryshe) përveç shitjes së aksioneve të pakicës në “Albgaz”;

v. nëse “Albgaz” nuk paraqet për asnjë arsye njoftimin me shkrim të pakthyeshmë për qëllimin e tij për të ushtruar Opsionin e Blerjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar të paktën gjashtë (6) muaj para datës së pestë të datës së kësaj Marrëveshjeje, Opsioni i Blerjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar do të skadojë pa efekt.

8.2 Dhënia e Opsionit të Shitjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar.

a) “Albgaz” i jep “Snam”-it të drejtën dhe mundësinë për të shitur, pa pengesa, aksionet e pakicës (“Opsioni i Shitjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar”). Me ushtrimin e “Snam”-it nga Opsioni i Shitjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar, “Albgaz” do të blejë dhe “Snam” do të shesë aksionet e pakicës. E drejta e Opsionit të Shitjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar që i është dhënë “Snam”-it mund të ushtrohet sipas termave dhe modaliteteve të përcaktuara më poshtë.

i) Çmimi për aksionet e pakicës korrespondon me çmimin e zbatueshëm të llogaritur sipas nenit 8.1 (a);

ii) Opsioni i Shitjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar mund të ushtrohet nga Snam në çdo kohë pas tre vjetorit të themelimit të “NewCo” (“Afati i Opsionit të Shitjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar”), duke i dhënë njoftim me shkrim Albgaizit për zgjedhjen e tij për të

ushtruar Opsionin e Shitjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar (“Njoftimi për Opsionin e Shitjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar”);

iii) Në rast se Opsioni i Blerjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar është ushtruar në mënyrë të rregullt, “Snam” nuk do të ketë detyrime të mëtejshme (si garanci, dëmshpërblim ose ndryshe) përveç shitjes së aksioneve të pakicës në “Albgaz”.

8.3 Procedura e Opsionit të Shitjes dhe Blerjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar.

a) “Snam” ose “Albgaz” (sipas rastit), përkatësisht me njoftimin e Opsionit të Shitjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar dhe njoftimin për Opsionin e Blerjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar, do t’i komunikojë palës tjetër çmimin e zbatueshëm për aksionet e pakicës, të llogaritur sipas nenit 8.1 (a) (iii) më lart (“Pagesa”) në njoftimin përkatës të opsionit. Snam ose Albgaz (sipas rastit) do të kenë afat 30 (tridhjetë) ditë pune nga marrja e njoftimit të Opsionit të Shitjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar dhe njoftimit për Opsionin e Blerjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar, sipas rastit, për të verifikuar korrektësinë/saktësinë e llogaritjes së Pagesës dhe për t’i dhënë Palës tjetër llogaritjen e saj të Pagesës, në masën e ndryshme nga ajo e komunikuar (“Njoftimi i Mosmarrëveshjes”). Nëse nuk bëhet njoftim për mosmarrëveshje brenda 30 (tridhjetë) Ditëve të Punës, atëherë Pagesa e komunikuar në Njoftimin për Opsionin, sipas rastit, do të jetë përfundimtare dhe detyruese për Palët.

b) Nëse është dërguar një njoftim i mosmarrëveshjes, atëherë Palët do të kenë një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh pune për të gjetur një marrëveshje për Pagesën. Në rast se Palët arrijnë një marrëveshje mbi shumën e pagesës, atëherë shumën e rënë dakord do të konsiderohet si përfundimtare dhe detyruese për Palët. Në rast se Palët nuk arrijnë një marrëveshje mbi shumën e duhur si Pagesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve të punës, llogaria përkatëse i dërgohet një eksperti të pavarur për të qenë një firmë ndërkombëtare e njohur që ofron shërbime të tilla (“Eksperti”) e



caktuar me marrëveshje të ndërsjellë të Palëve ose, në rast mosmarrëveshjeje, nga Sekretari i Përgjithshëm i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, me kërkesë të Palës më të përkushtuar. Eksperti do të marrë vendimin e tij mbi Pagesën brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve të punës nga emërimi dhe do të jetë përfundimtar dhe detyrues për Palët, me kusht që vendimi i tillë përfundimtar dhe detyrues mund të apelohej në përputhje me procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të përcaktuara në këtë Marrëveshje vetëm për shkak të një gabimi material. Kostot dhe tarifat e Ekspertëve do të paguheshin nga Palët, në shuma të barabarta (50% nga secila Palë). Palët do të japin dhe do të marrin masa që Ekspertit t'i jepet akses i tillë në librat dhe regjistrat e Shoqërisë, në mënyrë që të lejojnë Ekspertin të përcaktojë Pagesën.

c) Transferimi i aksioneve të Pakicës pas një ushtrimi të vlefshëm të Opsionit të Shitjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar dhe njoftimin për Opsionin e Blerjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar, sipas rastit (“Përfundimi i Opsioneve”) për “Albgaz” do të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve të punës nga data në të cilën Paga do të bëhet përfundimtare dhe detyruese midis Palëve (“Data e Përfundimit të Opsionit”), në vendin dhe kohën kur “Snam” do të njoftojë me shkrim “Albgaz”-in të paktën 10 (dhjetë) Ditë Pune para (në rast se ushtrohet Opsioni i Shitjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar) ose “Albgaz” do të njoftojë “Snam” me shkrim të paktën 10 (dhjetë) Ditë Pune para (në rast se ushtrohet Opsioni i Blerjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar), sipas rastit. Me Përfundimin e Opsionit, “Snam” dhe “Albgaz” ndërmarrin të gjitha hapat dhe veprimet e nevojshme për të kryer transferimin e aksioneve të pakicës.

9. KONFIDENCIALITETI

9.1 Secila Palë në këtë mënyrë merr përsipër të:

a) mbajë të fshehtë çdo informacion jopublik të marrë si rezultat i ose në lidhje me këtë Marrëveshje, Marrëveshjen e Aksionerëve, projektin dhe “NewCo”, biznesin e tyre përkatës (qoftë të përcaktuar në mënyrë specifike si “konfidenciale” ose ndryshe), përpilimin, studimet ose dokumentet e tjera të përgatitura nga cilado nga Palët dhe/ose nga ndonjë këshilltar ose konsulent ose auditues për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje dhe

të ndërmarrjes së përbashkët (të gjitha këto të përmendura më poshtë, të referuara bashkërisht si “Informacion Konfidencial”);

b) mos përdorë asnjë informacion konfidencial për ndonjë qëllim të ndryshëm nga ata të parashikuar nga kjo marrëveshje;

c) miratojë protokollet e “ekipit të pastër” dhe procedurat e garancisë që synojnë parandalimin e rreziqeve të shkëmbimeve ndërmjet Palëve, të informacionit sensitiv për qëllime të tjera, përveç atyre qëllimeve të kufizuara

9.2 Pavarësisht nga sa më sipër, çdo informacion konfidencial mund të njoftohet tek drejtorët, zyrtarët, punonjësit, konsulentët, audituesit, huadhënësit dhe përfaqësuesit e Palëve dhe të anëtarëve të tyre, të cilët duhet të jenë në dijeni të këtij informacioni për qëllimet e parashikuara nga kjo Marrëveshje (duke nënkuptuar, si kusht për dhënien e informacioneve shpjeguese, drejtorët, zyrtarët, punonjësit, konsulentët, audituesit, huadhënësit dhe përfaqësuesit e tyre, të natyrës konfidenciale të një informacioni të tillë dhe do të udhëzohen dhe marrin përsipër të trajtojnë informacionin e tillë konfidencial në përputhje me këtë Marrëveshje).

9.3 Detyrimet e konfidencialitetit të përcaktuara në këtë nen 9 nuk zbatohen për: i) çdo informacion konfidencial, i cili në kohën e pranimit ishte publik ose është bërë publik më pas, pa faj të palës pritëse; ii) çdo zbulim të informacionit konfidencial që kërkohet sipas ndonjë ligji, rregulloreje ose urdhri të lëshuar nga një qeveri ose rregullator tjetër burse ose një autoriteti tjetër kompetent që ka juridiksion mbi Palët (ose filialet e tyre), me kusht që Pala zbuluese/njoftuese duhet (x) të njoftojë me shkrim Palën tjetër për një kërkesë të tillë; dhe y) të mos zbulojë asnjë informacion konfidencial, përveç asaj që kërkohet në mënyrë specifike me shkrim nga autoriteti kërkues; iii) nëse është e nevojshme për përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje.

10. MOSKRYERJA E BIZNESIT KONKURRUES

10.1 Secila Palë merr përsipër, për kohëzgjatjen e kësaj Marrëveshjeje, të mos kontaktojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, menaxherët, drejtorët, punonjësit, konsulentët, klientët, furnitorët ose agentët e palëve të tjera, shoqëritë e palëve të tjera ose të “NewCo”, as ndryshe të kërkojnë nxjerrjen nga subjekte të tilla të lajmeve dhe informacionit në lidhje me ndërmarrjen e përbashkët, përveç nëse



dhe në masën që kërkohet për përmbushjen e marrëveshjeve të ekzekutuara për zbatimin dhe menaxhimin e ndërmarrjes së përbashkët.

10.2 Për kohëzgjatjen e kësaj Marrëveshjeje dhe për 2 (dy) vjet pas përfundimit të saj për çfarëdo arsye, secila Palë më tej merr përsipër, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në çfarëdo mënyre, duke përfshirë nëpërmjet bashkëpunëtorëve ose ndryshe, as të kërkojë për punësim, qoftë drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, as ndryshe të punësojë si konsulentë ose kontraktues të pavarur ose të përdorë, në ndonjë mënyrë, drejtuesit e lartë të Palës tjetër, filialeve të Palës tjetër ose “NewCo”.

10.3 Heqjet e mundshme dorë nga dispozitat sipas këtij neni 10 do të bihen dakord midis Palëve, nëse kjo do të konsiderohet e nevojshme dhe/ose e përshtatshme për qëllimet e përmbushjes më të mirë të ndërmarrjes së përbashkët.

11. NJOFTIMET

11.1 Pa cenuar detyrimet që rrjedhin nga ligjet në fuqi ose që rrjedhin ndryshe nga pjesëmarrja e Palëve në “NewCo”, asnjëra Palë nuk do të bëjë ose publikojë ndonjë njoftim, komunikim, reklamim ose njoftime të ngjashme në lidhje me ekzekutimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjes së Aksionerëve ose ndonjë nga transaksionet e parashikuara në të, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër për formën, përmbajtjen dhe kohën e njëjtë. Kjo dispozitë nuk do të zbatohet, megjithatë, për çdo njoftim, komunikim ose deklaratë me shkrim që kërkohet të bëhet nga ligjet e zbatueshme ose sipas rregullave të ndonjë organi qeveritar ose ndonjë autoritet të bursës, përveç kur Pala ose filialet e saj të kërkuara për të bërë një njoftim të tillë, komunikimi ose deklarata me shkrim, në masën e lejuar nga ligjet e zbatueshme dhe praktike, konsultohen me Palën tjetër në lidhje me kohën dhe përmbajtjen e njoftimit të tillë, komunikimit ose deklaratës me shkrim para se të bëhet njoftimi, komunikimi ose deklarata me shkrim.

12. ETIKA E BIZNESIT DHE ANTIMITMARRJES

12.1 Palët marrin në konsideratë dhe ndajnë parimet e etikës korporative dhe në veçanti luftës kundër korrupsionit. Palët nuk do të angazhojnë, autorizojnë apo lejojnë ndonjë veprim në lidhje me negocimin, përfundimin ose përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje, që do të shkaktonte që Palët dhe / ose filialet e Palëve të ishin në kundërshtim me

ndonjë ligj antikorrupsion ose antimitmarrje. Ky detyrim zbatohet në veçanti për pagesat e paligjshme, duke përfshirë pagesat lehtësuese për zyrtarët qeveritarë, përfaqësuesit e autoriteteve publike ose bashkëpunëtorët e tyre, familjet ose miqtë e ngushtë. Secila Palë bie dakord që nuk do të ofrojë, japë ose bjerë dakord për dhënien e pëlqimit për çdo punonjës, përfaqësues ose palë të tretë që vepron në emër të Palës tjetër ose të pranojë ose bie dakord të pranojë nga ndonjë punonjës, përfaqësues ose palë e tretë që vepron në emër të Palës tjetër, ndonjë dhuratë ose përfitim të panevojshëm, qoftë monetar ose tjetër, për negocimin, lidhjen ose përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje.

12.2 Çdo Palë do të njoftojë menjëherë Palën tjetër me shkrim, nëse vihet në dijeni ose ka dyshime specifike për korrupsion në lidhje me negocimin, lidhjen ose përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje.

12.3 Palët, si aksionerë të ardhshëm të “NewCo”, marrin përsipër që të garantojnë që “NewCo” do t’i përmbahet dhe do të jetë plotësisht në pajtim me të gjitha ligjet e zbatueshme përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare.

12.4 Në këtë kuadër, Palët do të angazhohen për të siguruar që “NewCo” të miratojë dhe zbatojë procedurat standarde më të mira moderne për luftën kundër korrupsionit dhe për parandalimin e mashtrimeve, duke përfshirë pa kufizim kodet e etikës dhe kontrollit të brendshëm dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut, plotësisht në përputhje me ligjet e zbatueshme.

13. TË NDRYSHME

13.1 Marrëveshja e plotë; amendimet. Kjo Marrëveshje dhe shtojcat e saj përbëjnë të gjithë marrëveshjen ndërmjet Palëve në lidhje me objektin në fjalë. Çdo amendament i kësaj Marrëveshjeje do të bëhet me shkrim nga palët ose nga pasuesit ose drejtëmarrësit e tyre përkatës, nëse ka. Në rast të mosrespektimit të këtyre dispozitave, amendamenti do të jetë i pavlefshëm dhe nuk do të ketë efekt.

13.2 Mosdelegimi. Përveç kur parashikohet më poshtë, asnjëra prej Palëve, pa miratimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, nuk mund të caktojë/transferojë, japë ndonjë interes garancie, mbajë në mirëbesim ose në ndonjë mënyrë tjetër të transferojë përfitimin e të gjithë ose ndonjë pjesë të



kësaj Marrëveshjeje.

“Snam” ka të drejtë të caktojë një filial 100% në pronësi të plotë (“Filiali”) për të marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e kësaj Marrëveshjeje dhe për të kryer aktivitetet që do të kryhen në Përfundim në përputhje me Klauzolën 4, në bazë të pëlqimit paraprak me shkrim të “Albgaz”-it, i cili nuk do të pengohet ose vonohet pa arsye, me kusht që si pjesë e këtij përcaktimi “Snam” të mbetet bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbushjen e të gjitha detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje gjatë të gjithë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje. Gjithashtu, nënkuptohet se mbajtja/zbritja ose vonesa nga “Albgaz” e pëlqimit të vet nuk do të konsiderohet “e paarsyeshme” në rast se: a) përcaktimi nga “Snam” i një Filiali në përputhje me këtë Klauzolë do të rezultonte në shkelje të ligjeve të zbatueshme; ose b) personi i caktuar është materialisht inferior ndaj “Snam”-it në lidhje me kapacitetin dhe burimet e tij teknike.

13.3 Toleranca. Toleranca nga secila Palë për shkelje të Palës tjetër të një ose më shumë dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nuk përbën dhe nuk do të konsiderohet se vepron si heqje dorë nga kjo Palë e të drejtave të kësaj Palë që rrjedhin nga shkelja e lartpërmendur. Një heqje dorë do të ketë efekt vetëm nëse bëhet në një dokument me shkrim dhe përfshin tregues specifik të përmbajtjes dhe objektit të heqjes dorë, të ekzekutuar siç duhet nga Pala që heq dorë.

13.4 Ndashmëria. Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje konstatohet të jetë ose bëhet e pavlefshme ose e pazbatueshme sipas ligjeve në fuqi, nga një gjykatë e ligjit, vlefshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndikohen ose dëmtohen në asnjë mënyrë. Në këtë rast palët do të negociojnë në mirëbesim, me qëllim që të ndryshojnë këto dispozita në dispozita reciprokisht të pranueshme, të cilat do të mundësojnë arritjen sa më afër të jetë e mundur të të njëjtit efekt tregtar si dispozitat që janë konstatuar ose bërë të pavlefshme ose të pazbatueshme.

13.5 Njoftimet. Çdo komunikim ose njoftim i kërkuar ose i lejuar për t’u njoftuar ose dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhet në gjuhën angleze me korrier, letër, faks ose e-mail dhe do të konsiderohet se është dhënë në mënyrë të rregullt dhe të vlefshme: i) në rastin e njoftimit të dërguar me letër ose korrier, pas marrjes së tij; dhe ii) në

rastin e njoftimit të dërguar me telefaks ose me e-mail, me lëshimin, përkatësisht të një raporti të dorëzimit me sukses me faks ose konfirmim dorëzimi me anë të softuerit të menaxhimit të e-mail-it, të drejtuar në çdo rast, në adresat e mëposhtme:

a) Nëse i drejtohen “Snam”:

SNAM S.p.A.

Piazza Santa Barbara 7

20097 - San Donato Milanese (Itali)

Telefon: 0237039613/0237039465

Numri i faksit: 02.3703.9227

Në vëmendje të: z. Sergio Busato dhe z. Mario Franchin

E-mail: Sergio.Busato@snam.it

dhe Mario.Franchin@snam.it

me kopje për: Michela Schizzi

E-mail: michela.schizzi@snam.it

b) Nëse i drejtohen “Albgaz”:

ALBGAS sh.a.

Blv. Zhanë d’Arkë, 3, Tiranë (Shqipëri)

Telefon: -

Numri i faksit: -

Në vëmendje të: z. Arbër Avrami

E-mail: arber.avrami@albgaz.al

dhe info@albgaz.al

Palët zgjedhin adresat e mësipërme si vendbanimet e tyre përkatëse për çdo fushë që lidhet me këtë Marrëveshje, duke përfshirë çdo njoftim gjyqësor.

Çdo ndryshim në adresat e mësipërme do të jetë në fuqi vetëm nëse njoftohet me shkrim nga pala e interesuar

14. LIGJI RREGULLUES DHE JURIDIKSIONI

14.1 Kjo Marrëveshje dhe çdo detyrim jokontraktual që rrjedh prej saj do të rregullohen, interpretohen dhe zbatohen në përputhje me ligjet e Shqipërisë.

14.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të zgjidhen përfundimisht sipas Rregullores së Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë nga 3 arbitrat e emëruar në pajtim me Rregullat e lartpërmendura. Vendi i arbitrazhit do të jetë Paris (Francë) dhe gjuha e arbitrazhit do të jetë gjuha angleze.



Shtojcat:

Shtojca A. Pasqyra e Termave dhe Kushteve

Materiale të Marrëveshjes së Aksionerëve

Shtojca B. Parimet dhe politika e prokurimit

[Nënshkrimi në faqen në vijim]

Tiranë, 11 qershor 2018

“Albgaz” sh.a..

Emri: Arbër Avrami

Pozicioni: Administrator

“Snam” S.p.a.

A. Fusha e veprimit

1. Palët	• “Albgaz” • “Snam”
2. Objekti i shoqërisë	Qëllimi korporativ i “NewCo” është realizimi i Fushës së Veprimit. Për këtë qëllim, palët do të përfshijnë një qëllim të përshtatshëm korporativ në aktet nënligjore

B. Ndarja e aksioneve, menaxhimi dhe qeverisja e “NewCo”

3. Ndarja e aksioneve të “NewCo”	“NewCo do të përfshihet në formën e një shoqërie aksionere sipas ligjeve shqiptare dhe pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, “Snam” dhe “Albgaz” do të zotërojnë kuotat e përcaktuara në klauzolën 4.1 (a) të kësaj Marrëveshjeje dhe kapitali aksioner do të përbëhet, siç përcaktohet në të. Çdo shumë shtesë do të ndahet në një rezervë primi të aksioneve bazuar në një procedurë të kërkesave për pagesë për kapital të parashikuar të ardhshëm dhe shpenzime operative. Çdo prim i aksioneve do të rimbursohet për “Snam” ose “Albgaz”, sipas rastit, nëse rrethanat e tyre përkatëse ekonomike e kërkojnë këtë.
4. Mbledhja e aksionerëve	Mbledhja e Aksionerëve do të ketë vetëm kompetencat e parashikuara me ligj sipas ligjit shqiptar. Vendimet/rezolutat e mbledhjes së aksionerëve merren në mënyrë të vlefshme me praninë dhe votimin e favorshëm të aksionerëve që përfaqësojnë përqindjen e kapitalit të kërkuar nga ligji shqiptar: - shumica e thjeshtë kërkohet përgjithësisht për rezoluta të zakonshme; - miratimi i disa rezolutave të jashtëzakonshme duhet të jepet me të paktën 3/4 e kapitalit aksioner të pranishëm në mbledhje (me kusht që të paktën shumica e kapitalit aksioner të jetë e pranishme): d.m.th. rritja e kapitalit, mbyllja/shpërndarja e shoqërisë . Rezolutat/vendimet në lidhje me çështjet e renditura më poshtë merren vetëm në mbledhjen e aksionerëve (ose ndonjë organ tjetër kompetent korporativ) me votën e favorshme të “Snam”: i. ndryshimet në aktet nënligjore; ii. rritja ose zvogëlimi i kapitalit aksioner, bashkimi, ndarja, riorganizimi ose transformimi, çdo transaksion tjetër i jashtëzakonshëm, duke përfshirë lëshimin e instrumenteve financiare; iii. pagimi i dividendëve dhe ndryshimi i politikës së dividendit; iv. miratimi dhe/ose revokimi i mbylljes, likuidimit ose shpërndarjes vullnetare, emërimi dhe/ose largimi i likuiduesve përkatës dhe dhënia ndaj tyre e kompetencave përkatëse; v. kompensimi i çdo anëtar të Bordit Mbikëqyrës dhe Administratorëve në një masë më të madhe sesa një prag/kufi që do të bihet dakord në Marrëveshjen e Aksionerëve; (“Çështje të rezervuara të aksionerëve”) Pavarësisht nga sa më sipër, nëse Drejtori i Përgjithshëm, Drejtori i Përgjithshëm Operacional ose Bordi Mbikëqyrës, sipas rastit, synojnë t’i nënshtrojnë miratimit të

Emri: Sergio Busato

Pozicioni: Drejtor i Përgjithshëm për Zgjidhjet Globale

SHTOJCA A

PASQYRA E TERMAVE DHE KUSHTEVE

MATERIALE TË MARRËVESHJES SË

AKSIONERËVE

Ky dokument përmbledh parimet kryesore të qeverisjes korporative që do të përfshihen në Marrëveshjen e Aksionerëve që do të lidhet në Datën e Përfundimit ndërmjet “Snam” dhe “Albgaz”, si aksionerë të “NewCo”.



	aksionerëve, një çështje që do të përfshihej në çështjet e Bordit Mbikëqyrës (siç përcaktohet më poshtë), atëherë çështjet e tilla duhet të miratohen vetëm nga aksionerët me votën e favorshme të “Albgaz”-it dhe “Snam”-it, nëse një pëlqim i tillë do të ishte i zbatueshëm në rast se vendimi do të ishte miratuar nga Bordi Mbikëqyrës.
5. Bordi Mbikëqyrës	Bordi Mbikëqyrës do të përbëhet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në klauzolën 4.1(c) (vii) të Marrëveshjes. Kryetari i Bordit Mbikëqyrës nuk mund të votojë. Nëse ndonjë nga Mbikëqyrësit pushon së qeni në detyrë për çfarëdo arsye, pala që ka caktuar këtë anëtar ka të drejtë të caktojë zëvendësin e tij / saj. Bordi Mbikëqyrës mblidhet jo më pak se 4 (katër) herë në vit. Bordit Mbikëqyrës i jepen kompetenca mbikëqyrëse të “NewCo”, siç parashikohet nga ligjet e zbatueshme dhe, si rrjedhojë, do të kryejë ose do të marrë masa për kryerjen e ndonjë veprimi të nevojshëm ose të dobishëm në lidhje me ose pjesëmarrje për arritjen e qëllimit korporativ të “NewCo”. Gjithashtu, çdo veprim për objektin e çështjeve të rezervuara të aksionerëve do të kërkojë votimin konfirmues paraprak të Bordit Mbikëqyrës.
6. Administratorët	Bordi Mbikëqyrës emëron Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv (i cili do të veprojë gjithashtu si përfaqësues ligjor i “NewCo” para palëve të treta) dhe Drejtori i Përgjithshëm Operacional (bashkërisht të referuar si “Administratorët”). Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv do të ketë fushat e mëposhtme kryesore të përgjegjësisë: - TIK; - Marrëdhëniet me jashtë; - Prokurimi, çështjet ligjore dhe burimet njerëzore; - (AFC) Kosto mesatare fikse. Zyrtari i Prokurimit i emëruar nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv do të caktohet nga “Snam”. Drejtori i Përgjithshëm Operacional duhet të ketë fusha e mëposhtme kryesore të përgjegjësisë: - Operimi dhe mirëmbajtja; - Shëndeti, siguria dhe mjedisi. Për qëllim të qartësisë, kompetencat që i delegohen Drejtorit të Përgjithshëm duhet të përfshijnë mundësinë e përzgjedhjes dhe përdorimit preferencial/parësor të raporteve dhe të punonjësve të tjerë që i raportojnë atij në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Në bazë të sa më sipër dhe vendimit të emërimit të Bordit Mbikëqyrës, Administratorët u nënshtrohen kompetencave më të zgjeruara të menaxhimit të “NewCo” dhe, për rrjedhojë, të kryejnë ose të marrin masa për kryerjen e ndonjë veprimi të nevojshëm ose të dobishëm në lidhje me ose pjesëmarrjen në arritjen e qëllimit korporativ të “NewCo”, në bazë të çështjeve të caktuara që kërkojnë paraqitjen paraprake dhe miratimin nga Bordi Mbikëqyrës (seksioni 7 më poshtë). Administratorët do të kenë fuqi të përbashkët nënshkruese për çështjet e mëposhtme: - në çështjet e rezervuara të Bordit Mbikëqyrës; - për çdo veprim përfundimtar në lidhje me çështjet e rezervuara të Bordit Mbikëqyrës; - në bilanc. Për të gjitha çështjet e tjera që lidhen me procesin funksional dhe çështjet që raportojnë për përgjegjësinë e tyre për fushat e tyre përkatëse, Administratorët duhet të kenë fuqi individuale nënshkruese. Nëse ndonjë nga administratorët pushon së qeni në detyrë për çfarëdo arsyeje, pala që ka caktuar këtë Drejtor ka të drejtë të caktojë zëvendësin e tij/ të saj, në përputhje me ligjet e zbatueshme. Administratorët i raportojnë Bordit Mbikëqyrës për kryerjen e detyrave të tyre të paktën mbi baza tremujore.



7. Miratimi paraprak i Bordit Mbikëqyrës	Deri në masën e lejuar nga ligji shqiptar, mbledhjet e Bordit Mbikëqyrës zhvillohen në mënyrë të vlefshme në prani të shumicës së anëtarëve të tij që marrin pjesë ose personalisht, ose nëpërmjet video-konferencës/ telekonferencës, me kusht që anëtarët e caktuar nga “Snam” të jenë të pranishëm. Në rast se në takim nuk është arritur kuorumi, takimi do të shtyhet dhe do të thirret përsëri pas 5 ditëve të punës në të njëjtën rend dite. Në këtë takim të dytë, Bordi Mbikëqyrës do të zhvillohet në mënyrë të vlefshme në praninë e shumicës së anëtarëve të tij, të cilët do të marrin pjesë ose personalisht, ose nëpërmjet video konferencës/telekonferencës . Vota konfirmuese e të gjithë anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës do të kërkohet për të gjitha çështjet e rezervuara. Çështjet e rezervuara përbëhen nga: – Miratimi i planit të biznesit, buxheti vjetor ose ndonjë ndryshim të tyre; – Çdo ndryshim material në natyrën dhe fushën e veprimit të “NewCo”, krijimin dhe braktisjen e linjave të biznesit, si dhe përcaktimin e parimeve themelore të politikës së biznesit; – Planet financiare vjetore ose afatgjata dhe niveli i borxhit; – Çdo blerje ose disponim i aktivëve të prekshëm ose të paprekshëm (duke përfshirë pjesëmarrje, pasuri të paluajtshme, pronësi intelektuale) për një vlerë që tejkalon një shumë që do të bihet dakord për një aset të vetëm; – Çdo marrëveshje apo transaksion që nuk është parashikuar nga Plani i Biznesit ose Buxheti, të cilat: a) nuk është janë brenda rrjedhës së zakonshme të biznesit dhe të nevojshme për kryerjen e biznesit të Ndërmarrjes së Përbashkët; dhe b) tej kalojnë shumën e caktuar për çdo rast të veçantë dhe në total në një vit biznesi; – Çdo politikë e supozimit të borxhit (duke përfshirë huan aksionere) ose dhënien e ndonjë garancie ose dëmshpërblimi, vlera e të cilit tejkalon një vlerë të caktuar; – Çdo vendim në lidhje me hyrjen, modifikimin, tërheqjen, ndërprerjen ose heqjen dorë nga të drejtat ose veprimet kundër, çdo konfirmim ose pranim të ndonjë kërkesë ose veprimi të ndonjë zgjidhjeje në lidhje me: i) Marrëveshjen e Shërbimeve të TAP; ii) marrëveshjet e shërbimeve ndërmjet “NewCo” dhe aksionerëve të saj; – Lidhja e marrëveshjes së ndërmarrjes së përbashkët, partneritetit, shërbimeve që nuk parashikohet nga: a) Plani i Biznesit; b) Buxheti; ose c) marrëveshjet e shërbimeve që nuk kërkojnë pajtueshmëri me politikat e ofertimit ose prokurimit; – Çdo punësim të një drejtuesi të lartë që nuk është parashikuar në Planin e Biznesit, pa cenuar të drejtën e emërimit/aktimit që u atribuohet aksionerëve; – Miratimi i çdo ndryshimi të rëndësishëm në politikat kontabël të “NewCo”; – Dhënia e kompetencave (ose ndonjë ndryshim të tyre) Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, Drejtorit të Përgjithshëm Operacional ose ndonjë drejtuesi të lartë, duke përfshirë Drejtorin e Përgjithshëm Financiar dhe Administratorin e Operimit dhe Mirëmbajtjes; – Emërimi i ndonjë këshilltari të jashtëm ligjor në “NewCo”, duke nënkuptuar se në rast se këshilltari ligjor është emëruar për të ndërmarrë veprime gjyqësore kundër një prej aksionerëve, atëherë ky aksioner dhe përfaqësuesit e tij do të konsiderohen në konflikt dhe nuk kanë të drejtë vote, dhe kuorumi dhe shumica do të ndryshohen në përputhje me rrethanat; – Miratimi i Kodit të Etikës.
8. Financimi	Secili prej aksionerëve do të kontribuojë në shpenzimet për ngritjen e “NewCo” në raport me aksionet e tyre përkatëse në shoqëri, në shumën që do të bihet dakord pas përcaktimit të buxhetit. Funksionimi i vazhdueshëm i “NewCo” do të financohet nga flukset monetare të gjeneruara nga “NewCo”, në veçanti nga Marrëveshja e Shërbimeve TAP. Në rast të nevojave për financim, secili aksioner mund të ofrojë financim për “NewCo” nëpërmjet huas aksionere, në raport me aksionet e tyre përkatëse në shoqëri, duke nënkuptuar se çdo supozim borxhi është Çështje e rezervuar e Bordit Mbikëqyrës.



9. Çështjet e rezervuara	Në rast të ushtrimit të Opsionit të Shitjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar nga “Snam”, të drejtat e vetos të “Snam”-it në lidhje me Çështjet e Rezervuara të Aksionerëve të Çështjes dhe Bordi Mbikëqyrës nuk do të jenë më në fuqi dhe një votë me shumicë të thjeshtë e Aksionerëve ose anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës, sipas rastit, do të jetë e mjaftueshme për të marrë një vendim në lidhje me Çështjet e Rezervuara të Aksionerëve ose Çështjet e Rezervuara të Bordit Mbikëqyrës. Për qëllim qartësie, dispozita e mësipërme nuk zbatohet në rast të ushtrimit të Opsionit të Blerjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar nga AlbgaZ në afatin fillestar prej pesë vitesh. Palët do të bien dakord në marrëveshjen e Aksionerëve të cilët vendosin veto për të drejtat e “Snam”-it në lidhje me Çështjet e Rezervuara të Aksionerëve dhe Çështjet e Rezervuara të Bordit Mbikëqyrës nuk do të jenë më në fuqi në rast të ushtrimit të Opsionit të Blerjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar në rast të Afatit të Rinovimit.
10. Politikat e dividendëve	Politika e dividendëve është caktuar të ketë një dividend të rregullt vjetor në para të gatshme të paguar për aksionerët e tij në vend të riinvestimit të parave të gatshme në Ndërmarrjen e Përbashkët (JV) pas vitit të dytë të krijimit të Ndërmarrjes së Përbashkët.

C. Bllokimi dhe dalja

11. Bllokimi	Në bazë të dispozitave të Mekanizmit të Opsionit të Shitjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar, duhet të përcaktohet bllokimi i transfertave të aksioneve deri në mbarimin e vitit të pestë të themelimit të “NewCo”. Si rrjedhojë, Pala nuk do të caktojë ose transferojë në asnjë lloj mënyre kuotën e tyre përkatëse të “NewCo” pa pëlqimin e Palës tjetër. Pavarësisht nga sa më sipër, “Snam” do të ketë të drejtën të transferojë kuotat e saj tek NewCo dhe për rrjedhojë të transferojë Marrëveshjen e Aksionerëve tek çdo filial në pronësi të plotë të “Snam”-it.
12. Opsioni i Përbërë/mospërbushja e detyrimeve	Në rast ndryshimi të kontrollit (termi i tillë për “AlbgaZ” për t’u referuar Qeverisë shqiptare në Marrëveshjen e Aksionerëve) ose mospërbushjeje të detyrimeve (p.sh. falimentimi etj.) i “Snam”-it ose “AlbgaZ”, aksioneri në lidhje me të cilin përndodh një rast i opsionit të përbërë, do t’i ofrojë aksionet e tij për shitje aksionerit tjetër me Çmimin e Caktuar dhe procedura e caktuar në këtë Marrëveshje për Opsionet e Shitjes dhe Blerjes së Aktivëve/Aseteve me Çmim të Caktuar dhe në Kohë të Caktuar do të zbatohen <i>mutatis mutandis</i>.

D. Dispozitat e përgjithshme

13. Ligji rregullues dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve	Ligji shqiptar Arbitrazhi i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë
14. Konfidencialiteti	Detyrimet e konfidencialitetit për çdo informacion konfidencial gjatë afatit të Marrëveshjes së Aksionerëve dhe për 5 (pesë) vjet pas përfundimit të saj.



SHTOJCA B PARIMET DHE POLITIKA E PROKURIMIT

Qëllimi i kësaj shtojce B është prezantimi i parimeve themelore procedurale që rregullojnë prokurimin e shërbimeve nga “NewCo” që do të përfshihen në njërin nga dy skenarët e mëposhtëm:

- Skenari i parë: prokurimi i nënshtrohet rregullave të prokurimit publik; ose

- Skenari i dytë: në masën që prokurimi nuk i nënshtrohet ligjeve të zbatueshme dhe rregullave të prokurimit publik dhe lejon që prokurimi i këtyre shërbimeve të kryhet nga rregulla të tjera, mund të zbatohet skenari i dytë.

Skenari i parë:

1. Struktura e prokurimit në “NewCo”

Drejtori i emëruar i Përgjithshëm Ekzekutiv i “NewCo” do të jetë përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e një urdhri të prokurimit. Zyrtari i prokurimit emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv për të filluar prokurimin. Zyrtari i emëruar i prokurimit duhet të marrë të gjitha masat e mundshme për të siguruar një ndarje të qartë midis detyrave të zyrtarëve/personelit të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së ofertuesit fitues. Dy strukturat kryesore të një procesi prokurimi, janë:

- i. komisioni i prokurimit publik i ngarkuar për hartimin dhe përgatitjen e dokumenteve të tenderit, ftesave dhe çdo dokumenti tjetër përgatitor siç kërkohet për procesin e tenderit (Njësia);

- ii. komisioni vlerësues i cili zgjedh fituesin dhe shpall kontratën në fund të procesit të tenderimit (Komisioni).

Të gjitha kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas ligjeve të zbatueshme, duhet të merren parasysh gjatë emërimit të anëtarëve të njësise dhe Komisionit.

Në asnjë rrethanë, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv nuk lejohet që të jetë Njësi ose Komision, ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes së fituesit.

a) Kompetencat e njësise

Për secilën procedurë të prokurimit, në mënyrë specifike në varësi të objektit të prokurimit dhe objektit të punës, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv do të ngrejë një komision të prokurimit

publik (“Njësia”) të përbërë nga 3 zyrtarë, dy prej të cilëve janë caktuar nga “Snam” dhe një nga “Albgaz”. Një nga tre zyrtarët e Njësise është Zyrtari i Prokurimit (i cili është caktuar nga “Snam” dhe është pjesë e çdo Njësie të ngritur), dhe i dyti është një ekspert teknik i caktuar nga “Snam” me njohuri të zgjeruara në fushën e prokurimit. Zyrtari i tretë i cili emërohet nga “Albgaz” mund të varet nga objekti i prokurimit, por zakonisht është avokat dhe duhet të ketë njohuri të zgjeruara në lidhje me objektin/fushëveprimin e prokurimit. Në rast mungese të personelit/stafit, “Snam” ose “Albgaz”, sipas rastit, mund të vendosin të caktojnë personel të specializuar nga autoritetet e tjera kontraktuese, “Snam”, “Albgaz” ose ekspertë të jashtëm të kontratës.

Metodologjia dhe pesha specifike e secilit kriter në bazë të të cilit Komisioni do të kryejë vlerësimin e tij, përcaktohet nga Njësia, në veçanti nga eksperti teknik, për çdo kriter specifik që duhet vlerësuar nga Komisioni dhe, në mënyrë specifike, rezultatet që secili kriter do të ketë dhe mënyra se si do të llogaritet çdo ofertë, në mënyrë që Komisioni të gjejë një ofertues të suksesshëm. Formula e aplikuar parashikohet në kërkesën për propozime të përgatitur nga Njësia (në mënyrë specifike, dy anëtarët e caktuar nga “Snam”). Çdo kriter ose procedurë teknike që duhet të ndiqet, siç është caktuar nga Eksperti Teknik dhe Njësia, duhet të miratohet dhe ndiqet nga Komisioni.

Në veçanti, eksperti teknik i caktuar nga “Snam”, si pjesë e Njësise, do të kryejë detyrat e mëposhtme:

- Hartimi i specifikimeve teknike, kur ato nuk janë hartuar tashmë nga strukturat e tjera të brendshme;

- Llogaritja e fondit limit, nëse një detyrë e tillë ende nuk i është caktuar një strukturë tjetër;

- Hartimi i kriterëve specifike të pranimit, në raport me kërkesat teknike;

- Hartimi i kriterëve të vlerësimit, nëse është e zbatueshme;

- Përcaktimi i çdo informacioni tjetër specifik teknik që do të përdoret për objektin e prokurimit (p.sh., grafikët e pagesave);

- Organizimi, kryerja, mbikëqyrja dhe drejtimi i të gjitha aspekteve të procesit të prokurimit, duke përfshirë zgjedhjen e mënyrës më të mirë për përzgjedhjen e burimeve, konferencat para-



propozuese, komisionet e vlerësimit dhe ekipet negociuese;

- Kërkimi i propozimeve dhe/ose ofertave dhe planifikimi i të gjitha aktiviteteve të prokurimit për sigurimin e materialeve, furnizimeve dhe shërbimeve;

- Përgatitja dhe paraqitja e raporteve ose dokumenteve të departamentit në lidhje me procedurat e tenderit;

Tri kriteret e zbatueshme të përzgjedhjes do të jenë si më poshtë:

1. Për mallrat që kanë specifikime të thjeshta ose standarde të njohura teknike, kriteri i vlerësimit është oferta me çmim më të ulët.

2. Kriteri i tenderit ekonomikisht më të favorshëm do të përdoret në kontratat më komplekse, të cilat mund të konsiderohen si të një natyre të veçantë që përveç çmimit për punën/mallrat/shërbimet që përbëjnë objektin e kontratës, do të përmbajë gjithashtu elemente të tjerë me vlerë ekonomike, të cilat sjellin shpenzime të konsiderueshme për kostot e “NewCo”, si shërbimet pas shitjes, pjesët e këmbimit, zgjidhjet më të favorshme teknike, mbështetjen e ardhshme teknike ose ato që janë më pak ndotëse ndaj mjedisit. Në këtë rast, pesha e kriterit të çmimit nuk duhet të jetë më e vogël se 50 pikë. Rezultati maksimal që një ofertë do të marrë është 100 pikë.

3. Në masën që aktivitetet që duhet të kryhen nga një palë e tretë mund të kryhen nga një shoqëri e cila zotërohet të paktën 51% nga një subjekt/person shqiptar, shoqëria shqiptare do të ketë përparësi. Nëse kjo kërkesë nuk mund të plotësohet nga një shoqëri shqiptare, shoqëria e përzgjedhur do të jetë e autorizuar të nënkontraktojë minimalisht të paktën 30% të punës për të cilën kontraktohet nga Ndërmarrja e Përbashkët tek një shoqëri shqiptare.¹

4. Aplikanti duhet të jetë plotësisht në përputhje me ligjet e zbatueshme kundër mitmarries. Për sa i përket përputhshmërisë me ligjet e zbatueshme antimitmarrie, përveç dokumentacionit dhe deklaratës së paraqitur nga aplikantët, “NewCo” do të kryejë gjithashtu një test të pavarur nëpërmjet aktiviteteve të kontrolleve të reputacionit dhe antimitmarries që do të kryhen nga “Snam” në

bazë të një marrëveshjeje shërbimi që do të lidhet nga “Snam” dhe “NewCo”.

Njësia organizon procesin e prokurimit që mund të kryhet si një proces me një ose dy faza.

Në rastet e një procesi me një fazë, metodologjia për vlerësimin e ofertave përkatëse është siç tregohet në pikat 1 dhe 2 të këtij seksioni a. Në rastet e procesit me dy faza, kriteret teknike dhe tregtare kualifikuese janë kërkesat minimale dhe/ose maksimale që vlerësohen në bazë të kalimit/moskalimit gjatë fazës së parë. Kriteret e kualifikimit (kalimit/moskalimit) duhet të deklarohen në mënyrë që një vlerësim të mund të përcaktojë nëse propozimi/oferta është kryesisht përgjegjës/e ndaj kërkesave teknike dhe tregtare sipas shërbimit të kërkuar, siç përcaktohet në kërkesën përkatëse për propozime. Vetëm ofertuesit që i kalojnë kriteret teknike dhe tregtare të përcaktuara në fazën e parë kanë të drejtë të përzgjidhen për fazën e dytë të procesit të prokurimit në të cilën do të vlerësohet oferta financiare.

Përveç sa më sipër, çdo detaj përbërës, hap dhe lloj i cilësdo procedurë do të gjendet në ligjet e zbatueshme dhe Rregullat e Prokurimit.

b. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (Komisioni)

Komisioni caktohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe përbëhet nga tre anëtarë, me diploma arsimit të lartë, ku njëri prej anëtarëve do të jetë ekspert teknik i emëruar nga “Snam”. Dy anëtarët e tjerë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave do të emërohen nga “Albgaz”. Anëtarët e Njesisë nuk mund të emërohen si anëtarë të Komisionit. Kryesuesi i Komisionit do të jetë eksperti teknik i emëruar nga “Snam”, nëse ky i fundit është pjesë e zyrtarëve të lartë drejtues të “NewCo”.

Në rast mungesash të personelit, “Snam” ose “Albgaz”, sipas rastit, mund të vendosin të caktojnë personel të specializuar nga autoritetet e tjera kontraktuese, “Snam”, “Albgaz” ose ekspertë të jashtëm të kontratës si anëtarë të Komisionit. Komisioni është i vetmi përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjithë elementeve të ofertave për secilën fazë të procesit, bazuar në metodologjinë dhe kriteret e vendosura nga njësia, pavarësisht faktit nëse procesi i prokurimit kryhet në një fazë ose dy faza. Komisioni duhet të kryejë

¹ Ky kriter zbatohet vetëm në masën që midis ofertuesve, më shumë se një pjesëmarrës kanë oferta njëlojë të mira në bazë të kriterëve sipas pikave 1 dhe 2 më sipër.



detyrat e tij në pavarësi të plotë dhe si një organ unik dhe të gjithë anëtarët në përbërje të tij janë të barabartë në procesin e vendimmarrjes. Përveç kësaj, secili anëtar është ligjërisht i detyruar të nënshkruajë dhe të marrë përgjegjësinë e plotë për vlerësimin e kryer. Nëse kërkohet sqarim i mëtejshëm në lidhje me dokumentet e tenderit, Njësia do të japë përgjigjet përkatëse. Komisioni nuk do të kryejë asnjë detyrë tjetër përveç atyre të parashikuara këtu dhe në rregullat e prokurimit publik shqiptar.

Pas përzgjedhjes së ofertuesit të suksesshëm dhe para dhënies së kontratës, komisioni do të konsultohet, por nuk është ligjërisht i detyruar për miratimin e njësies në lidhje me vendimin përfundimtar për dhënien e kontratës. Kontrata përfundimtare me ofertuesin fitues përgatitet dhe finalizohet nga Njësia bazuar në Rregullat e Prokurimit dhe nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Ndërmarrjes së Përbashkët me propozim të Komisionit dhe i dorëzohet për nënshkrim Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv nga Zyrtari i Prokurimeve.

Nëse ekziston një mospërputhje ndërmjet procedurës së parashikuar në Skenarin e Parë dhe Rregullat e Prokurimit Publik/PPL, këto të fundit do të kenë përparësi.

Skenari i dytë:

Qëllimi i këtij skenari të dytë është paraqitja e parimeve procedurale rregulluese bazë të prokurimit për ato shërbime që nuk i nënshtrohen ligjit shqiptar për prokurimin publik nga “NewCo”. Procesi i plotë procedural nga kërkesa e departamentit kompetent për dhënien e kontratës, përbën sa më poshtë:

1. Kërkesa për prokurim

Departamenti kompetent në “NewCo”, në bazë të nevojave të procedurave teknike të punës dhe operacioneve të përditshme të Ndërmarrjes së Përbashkët, mund të kërkojë shërbime/furnizime shtesë nga shoqëri të palëve të treta. Në këtë kuadër, duhet të bëhet një kërkesë për Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv të “NewCo” për fillimin dhe përfshirjen e strukturave të prokurimit dhe procesit pranë “NewCo”.

2. Krijimi i Komisioneve të Prokurimit

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv duhet të marrë të gjitha masat e mundshme për të siguruar një ndarje të qartë midis detyrave të zyrtarëve /personelit të përfshirë në hartimin e dokumenteve

të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së ofertuesit fitues. Procesi do të jetë një procedurë vlerësimi në dy faza. Drejtori i emëruar i Përgjithshëm Ekzekutiv i “NewCo” do të jetë përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit. Grupi i punës ndahet në tre, një për çdo fazë të procedurës së tenderit si vijon:

i) Komisioni i Prokurimit, përgjegjës për hartimin dhe përgatitjen e të gjitha dokumenteve të nevojshme procedurale;

ii) Komisioni i Vlerësimit Teknik, përgjegjës për vlerësimin e të gjitha kriterëve teknike;

iii) Komisioni për Vlerësimin Ligjor dhe Tregtar përgjegjës për vlerësimin e të gjitha Kriterëve Ligjore dhe komerciale.

FAZA 1

1. Krijimi i Komisionit të Prokurimeve

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i “NewCo”, pas kërkesës nga Departamenti Kompetent, do të krijojë një Komision Prokurimi të përbërë nga të paktën 3 (tre) anëtarët e mëposhtëm:

i. Dy anëtarë të caktuar nga “Snam”, ku një duhet të jetë Ekspert Teknik;

ii. Një anëtar përgjegjës për procedurat e prokurimit, i caktuar nga “Albgaz”.

Kryetari i Komisionit caktohet bashkërisht në varësi të fushës së ekspertizës dhe Departamentit Kompetent.

(CD).

2. Objekti i punës dhe veprimtaria e Komisionit të Prokurimeve

Detyrat dhe objekti kryesor i punës së Komisionit të Prokurimeve ndahen në tri detyra kryesore si më poshtë:

i. Përgatitja e dokumenteve të tenderit dhe (RFP): Komisioni i Prokurimeve do të përgatisë të gjitha dokumentet e nevojshme të tenderit, duke përfshirë Kërkesën për Propozim (RFP) që do t’u dërgohet Aplikantëve/Ofertuesve të ardhshëm, duke përfshirë: a) një letër ftesë; b) informacion për konsulentët; c) termat e referencës (kriteret ligjore dhe kriteret teknike dhe tregtare); d) listën e dokumentacionit që duhet të paraqitet për të vërtetuar përputhshmërinë e plotë me ligjet antimitmarje; dhe e) kontratën e propozuar. Komisioni i Prokurimeve do të përdorë KPP-të standarde të zbatueshme me ndryshime minimale, sipas



nevojës për të trajtuar kushtet specifike të projektit.

Komisioni i Prokurimeve do të lejojë kohë të mjaftueshme për aplikantët që të përgatisin propozimet e tyre. Koha e lejuar do të varet nga natyra e shërbimeve, por zakonisht nuk duhet të jetë më pak se dy javë. Gjatë kësaj periudhe, aplikantët mund të kërkojnë sqarime në lidhje me informacionin e dhënë në RFP. Komisioni i jep këto shpjegime me shkrim dhe i sjell në vëmendje të të gjitha firmave në listën e përzgjedhur (që synojnë të paraqesin propozime).

a) Kriteret ligjore: Komisioni i Prokurimeve do të nxjerrë një listë të kriterëve ligjore që duhet të ndiqen nga ofertuesit e ardhshëm, të cilat përfshijnë vlefshmërinë e Aplikimit/Ofertës/Propozimit që kërkojnë që të gjithë formularët përkatës të nënshkruhen nga personi ose personat e autorizuar. Kriteret ligjore duhet të përfshijnë kërkesat e përgjithshme si të dhënat penale/dëshminë e penaltetit të Aplikantit/Ofertuesit ose përfaqësuesit të tij ligjor dhe kriteret e tjera në përputhje me rregullat e antimitmarjes dhe etikës të “Snam”;

b) Kriteret teknike dhe tregtare: Kriteret kualifikuese teknike dhe tregtare, duke përfshirë përputhshmërinë e plotë me ligjet e zbatueshme të antimitmarjes, janë kërkesat minimale dhe/ose maksimale në procedurat e pranueshmërisë që normalisht vlerësohen në bazë të kalueshmërisë /moskalueshmërisë. Kriteret kualifikuese (kaluese /moskaluese) duhet të deklarohen në mënyrë që një vlerësim të mund të përcaktojë nëse oferta/propozimi është kryesisht i përgjegjshëm ndaj kërkesave teknike dhe tregtare sipas shërbimit të kërkuar, siç përcaktohet në RFP. “NewCo”, bazuar në kontributin e Komisionit të Prokurimit, ka përfshirë në RFP të gjitha kriteret teknike dhe tregtare që duhet të përmbushen nga Aplikanti /Ofertuesit bazuar në objektin specifik të procedurës së prokurimit për të cilin është synuar.

Në zbatim të sa më sipër dhe në hartimin e RFP-së, komisioni i prokurimeve do të marrë parasysh se të gjitha standardet që do të ndiqen në procesin e prokurimit, kërkojnë një kontribut të detyrueshëm të standardeve dhe kriterëve të cilësisë nga “Snam” dhe TAP AG.

3. Publikimi i dokumenteve të tenderit

Pasi të kenë kaluar të gjitha dokumentet për hapat procedural dhe kontrollin e cilësisë së

standardeve, Komisioni i Prokurimeve do të lançojë/publikojë të gjitha thirrjet përkatëse për dokumentacionin e tenderit, duke përfshirë grupin e përmendur në klauzolën 2.i.

FAZA II

1. Krijimi i Komisioneve të Vlerësimit Teknik dhe Tregtar dhe Ligjor

i. Komisioni i Vlerësimit Teknik

Komisioni Teknik do të vlerësojë kontrollet e Cilësisë dhe Standardeve dhe duhet të kryejë Analizën Teknikë të ofertave në bazë të kalimit/moskalimit. Mosdhënia nga ky komision, e miratimit për cilësinë, standardet dhe kriteret teknike nënkupton që vlerësimet të mëtejshme nga Komisioni Ligjor dhe Tregtar nuk do të kryhen për ata aplikantë/ofertues që nuk do të marrin miratimin e lartpërmendur.

Komisioni Teknik do të caktohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe do të përbëhet nga 3 anëtarë:

a. Dy anëtarë të caktuar nga “Snam”, ku të paktën një prej tyre është ekspert teknik;

b. Një anëtar i caktuar nga “Albgaz”;

Kryetari i Komisionit do të jetë eksperti teknik i caktuar nga “Snam”. Komisioni duhet të kryejë detyrat e tij në pavarësi të plotë dhe si një organ unik dhe të gjithë anëtarët në përbërje të tij janë të barabartë në procesin e vendimmarjes. Përveç kësaj, secili anëtar është ligjërisht i detyruar të nënshkruajë dhe të marrë përgjegjësinë e plotë për vlerësimin e kryer.

ii. Komisioni i Vlerësimit Tregtar dhe Ligjor

Komisioni për vlerësim ligjor dhe tregtar vlerëson të gjithë aplikantët/ofertuesit, të cilët janë kualifikuar nga Komisioni Teknik. Ky komision do të vlerësojë kriteret tregtare, financiare dhe ligjore të ofertave të dorëzuara.

Komisioni për Vlerësimin Ligjor dhe Tregtar do të emërohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe do të përbëhet nga 3 anëtarë:

a) Dy anëtarë të caktuar nga “Albgaz”;

b) Një anëtar të caktuar nga “Snam”;

Për sa i përket përputhshmërisë me ligjet e zbatueshme të antimitmarjes, përveç dokumentacionit dhe deklaratës së paraqitur nga aplikantët, “NewCo” do të kryejë gjithashtu një test të pavarur nëpërmjet aktiviteteve të kontroleve të reputacionit dhe antimitmarjes që do të kryhen nga “Snam” në bazë të një marrëveshje shërbimi që do të lidhet nga “Snam” dhe “NewCo”.



2. Objekti i Punës dhe veprimtaria e dy Komisioneve të Vlerësimit

Detyrat dhe objekti kryesor i Komisioneve të Vlerësimit përbëhet nga vlerësimi i çdo Komisioni përkatës bazuar në rendin e mëposhtëm:

i. Kontrolli i Cilësisë, Standardeve dhe Teknik: Aplikanti/Ofertuesi duhet të jetë përgjegjës për të siguruar të gjitha standardet e kërkuara dhe kriteret e cilësisë, siç kërkohet nga kërkesat që duhet të vendosen në përputhje me pikën 2, të fazës I, nga “Snam” dhe TAP AG.

Nëse Aplikanti/Ofertuesi nuk mund të përmbushë këto kërkesa, ata do të konsiderohen të shkualifikuar nga procesi i mëtejshëm për vlerësimin e kriterëve të mëposhtme dhe më pas nga procedurat e tenderit.

ii. Analiza tregtare, financiare dhe/ose ligjore: Aplikanti/Ofertuesi është përgjegjës për të ofruar dokumentacionin që përfshin të dhënat penale të

Aplikantit/Ofertuesit ose përfaqësuesit ligjor të tij dhe kriteret e tjera në përputhje me rregullat e antimitmarjes dhe etikës të “Snam”.

iii. Vlerësimi i ofertave: Më pas të gjitha aplikimet/ofertat do të vlerësohen në bazë të një pikëzimi/vlerësimi të caktuar të vendosur nga Komisioni i Prokurimit në dokumentet e tenderit.

3. Miratimi dhe ekzekutimi përfundimtar

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit dhe renditjes përkatëse të pikëve të Aplikantit /Ofertuesve, Zyrtari i Prokurimeve do t'i dorëzojë rezultatet përkatëse Administratorëve (Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Drejtori i Përgjithshëm Operacional) dhe Bordit Mbikëqyrës. Përgatitja dhe negocimi i kontratës përfundimtare me ofertuesin fitues nga njësia, bazuar në Rregullat e Prokurimit dhe e nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Ndërmarrjes së Përbashkët me propozimin e Zyrtarit të Prokurimeve.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 168 lekë